



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Nisur nga një artikull në media mbi rritjen e çmimit të vajrave ushqimorë, Autoriteti i Konkurrencës sqaron si më poshtë:

Autoriteti i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” duke u mbështetur në tre shtylla kryesore:

- abuzimin me pozitën dominuese;
- marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe
- autorizimin për bashkimin dhe përqendrimin e ndërmarrjeve.

Autoriteti i Konkurrencës nuk është institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e çmimeve apo të cilësisë së produkteve të ndryshme ushqimore.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk janë depozituar ankesa, si nga ana e bizneseve, ashtu edhe nga ana e konsumatorëve, lidhur me rritjen e çmimit të vajrave ushqimorë, prej së paku 4 vitesh.